

GR. BRÂNCUȘ

Akademia Rumune

ATLASI DIALEKTOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE.
ELEMENTE TË PËRBASHKËTA ME RUMANISHTEN

Më 2007 dhe 2008, në Tiranë dolën në Institutin e Gjuhësisë dhe e Letërsisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dy vëllimet e para të Atlasit gjuhësor shqiptar¹, vepër e një grupi profesorësh të Universitetit të Tiranës: Jorgji Gjinari, Bahri Beci, Gjovalin Shkurtaç dhe Xheladin Gosturani; bashkëpunuan Anastas Dodi dhe Menella Totoni. Bashkërenditjen e punës përgatitore të nevojshme në përpunimin e një atlasit gjuhësor e siguroi J. Gjinari. Ai është, gjithashtu, autori i një hyrjeje me të dhëna të bollshme. Ky studim (botuar shqip dhe italisht) vë në dukje problemet e përgjithshme të dialektologjisë shqiptare, jep njohuri mbi historinë paraprake të kërkimeve për kryerjen e Atlasit, si edhe mbi përgatitjen dhe organizimin e hulumtimeve, mbi klasifikimin e materialit dhe redaktimin e hartave. Në të vërtetë, Atlasi hapet me një *Parathënie* të Mahir Domit, albanolog i brezit më të vjetër, që përkrahu gjithmonë, që nga mesi të shekullit të kaluar, ashtu si Eqrem Çabej dhe Al. Xhuvani, përpjekjen e gjuhëtarëve të rinj për të vëzhguar gjithë krahinat dialektore të vendit.

Hartat e Atlasit paraqesin veçoritë përbërëse të shqipes së përbashkët si dhe ndryshimet gjeografike të sotme së bashku me shkallët e tyre të ndërmjetme. Vendosija e izoglosave tregon zonat arkaike, më konservative, dhe trevat ku bëhen të dukshme risitë, ato të brendshme ose, në disa raste, risitë e shkaktuara nga kontakti i shqipes me gjuhët fqinje. Gjinari vëren se në anketat për Atlas u zbuluan jo vetëm variante fonetike të reja, por edhe disa forma gramatikore dhe fjalë deri atëhere të panjohura për gjuhësinë shqiptare. Prandaj, Atlasi i shqipes është jo vetëm një përshkrim i përpiktë i përbërjes dialektore të gjuhës por edhe një fond i pasur të dhënash lidhur me zhvillimin e saj nga periudha e përbashkët deri në epokën moderne. Gjithashtu, kjo vepër është interesante për studimin e shqipes bashkëkohore dhe të historisë së kësaj gjuhe.

¹ *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, 2007, vëllimi II, 2008, të botuara nga Università degli Studi di Napoli "L'Orientale", Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale.

Të dy dialektet kryesore, *toskë* (të folurit në jug) dhe *gegë* (në trevën veriore), me veçori të dalluese themelore që nga periudha e vjetër të gjuhës, janë njohur si norma në shkrimin letrar që nga fillimi i shekullit XIX. I pari tekst shqip, *Meshari* i Buzukut, është një përkthim i bërë më 1555 në dialektin verior. Për të përmendur kalimthi, në dialektin gegë ka shkruar, në fillimin e shekullit të kaluar, Gjergj Fishta, një nga poetët më të mëdhenj të vendit, që e ka njohur në mënyrë shembullore folklorin e malësorëve shqiptarë. Në të kaluarën u botuan në të dy dialektet shumë përmbledhje folklori letrar, libra gramatike dhe fjalorë. Disa gjuhëtarë kanë përpunuar edhe studime monografike mbi një seri të folmesh shumë interesante për vjetërsinë e tyre. Por, pas Luftës së dytë botërore, norma letrare ngulitet, me dekret zyrtar, mbi bazën e dialektit toskë.

Mendimi i përpunimit të një atlasit dialektologjik është mjaft i vjetër në gjuhësinë shqiptare. I nxitur nga hovi i punimeve kërkimore të gjeografisë gjuhësore në Evropë në gjysmën e parë të shekullit XX, Eqrem Çabej hartoi më 1943 një pyetësor për anketat të ardhshme dialektologjike në Shqipëri. Pas vitit 1950 ka dalë në Shqipëri një numër shumë i madh monografish dhe përshkrimesh të të folmeve, si dhe disa studime sintetizuese dhe kurse universitare dialektologjike. Ato janë plotësuar me rezultatet e kërkimeve mbi të folmet e shqipes jashtë vendit: Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Greqi, Itali jugore, Siqeli. Një pjesë e materialit gjuhësor nga këto zona, që janë veçanërisht ruajtëse, është pasqyruar në pika të posaçme në hartat e Atlasit.

Anketimet e mirëfillta zgjatën gati gjashtë vjet (1980-1985), mbi një rrjet shumë të dendur me 171 pika kartografike. Largësia midis lokaliteteve ku janë bërë anketat (jo vetëm fshatra, por edhe qytete) – e përsosur për studimin e hollësishëm të gjuhës së folur – është afërsisht 17 km (më e madhe në trevat malore, më e ngushtë në ato fushore). Nga shkaqe të kuptueshme kanë qenë pyetur sidomos të moshuarit.

Pyetësori themelor, që ka më shumë se gjashtëqind pyetje, është botuar në fundin e vëllimit të parë dhe përmban, përgjithësisht, fenomene të parashikueshme. Duhet bërë vërejtja, prandaj, se hulumtuesit kanë pasur ndërmend vërtetimin e këtyre fenomeneve mbi truall si fakte reale të gjuhës së folur dhe, sidomos, përfaqësimin e izoglosave që kufizojnë njësitë dialektore. Gjithashtu – fakt i rëndësishëm – veçoritë gjuhësore të parashikuara në pyetësor janë vështruar në perspektivën e funksionit të tyre në tërësinë e gjuhës si, për shembull, fenomenet fonetike të përsëritshme, ose prapashtesat dhe mbaresat në strukturën morfologjike dhe fonetike të fjalëve.

Duhet saktësuar se “pyetjet” fonetike dhe gramatikore janë hartuar në gjuhë specialisti në bazën e një përshkrimi të hollësishëm të fonetikës dhe të morfologjisë së të folmeve të shqipes. Hetuesit ndoqën realizimet konkrete dhe funksionet në fjalë të tingujve, si dhe strukturën e formave me variacionet të mundshme të morfemave.

Vëllimi i parë, me 360 harta, i kushtohet pjesërisht fonetikës dhe fonologjisë. Përmendim këtu hartat të cilat përmbajnë fenomene karakteristike: zanoret e theksuara (me opozicion kuantitativ: të gjata në gegërisht dhe të shkurtra në toskërisht), zanoret e hundorëzuara në gegërisht (dhe mungesa e hundorëzimit në toskërisht, me pasojën e rotacizmit të *n*-së), zhvillimi i togjeve zanore *ua* (*thua*), *ye* (*fyell*), *ie* (*dielli*), bashkëtingëllorja laringale *h* në pozita të ndryshme në fjalë, opozicioni i vibranteve *r*: *rr*, *ll* (grykore, me variantet e mundshme), spirantet *th*, *dh*, afrikatet (*ç*, *xh*), qiellzoret (*q*, *gj*), togjet *ng*, *nd*, *nb*, *ngj*, palatalizimi i bashkëtingëlloreve *p*, *b*, *f* (të ndjekura nga *l*) dhe *m* (+ *j*), zhvillimi i *u*-së (e ndjekur nga *ll*, *r*), në varësi nga karakteri i mbyllur ose të hapur të rrokjes (*hekur* – *hekri*), variacione theksi (*ai* – *aj*, *pará* – *páre* etj.).

Në fushën e gramatikës, hartat më të shumta përmbajnë veçori në lidhje me këto fakte:

asnjanësi², gjinia e emrave kolektivë, pasuria e mbaresave të shumësit (me ndryshime në strukturën e rrënjës), shenjat që dallojnë rasat (kallëzore, rrjedhore), nyja shquese e prapme, emërzimi i mbiemrit, larmia e trajtave përemërore pronore, e tashmja e dëftores së foljeve ndihmëse dhe të një vargu klasash foljore më të shpeshta, trajtat e foljes ndihmëse në strukturën e të shkuarës, tipat e së ardhmes, paskajorja, urdhërorja e diatezës vetvetore/pësore, sintaksa e foljeve inkoative, vlerat e një vargu parafjalësh, lidhja në strukturën e fjalive qëllimore etj.

Vëllimi i dytë i është kushtuar tërësisht leksikut, përgjithësisht popullor, të organizuar mbas kriterit semantik: fenomene të natyrës, bujqësi, faunë, florë, farefisni, pjesët e trupit, banesë, zanate, përdorëse dhe vegla, kohë, hapësirë, numra. Në fundin e vëllimit ka një tregues shumë të dobishëm të fjalëve që janë në harta. Në treguesin e posaçëm të përpunuar për çdo hartë (në fletën e djathtë) janë regjistruar variantet fonetike dhe gramatikore të fjalëve bazë dhe veçan, në një kuadër, janë rreshtuar sinonimet e tyre. Mbi hartën e mirëfilltë, variantet e gjithëllojshme paraqiten me anë të simboleve (vija dhe figura gjeometrike me ngjyra). Këto hollësi teknike lehtësojnë kërkimin në Atlas.

Vende-vende, ka harta sintetizuese, që përfaqësojnë nga një grup më të madh fenomenesh, për shembull: seritë e zanoreve të theksuara, fjalët sinonime për “koçan” etj.

Për historinë e gjuhës rumune, Atlasi dialektologjik shqiptar paraqit një interes të veçantë, sepse ngjashmëritë e mëdha ndërmjet rumanishtes dhe shqipes pasqyrohen në harta me shtrirjen e saktë në vend. Që në fillim duhet saktësuar se njëjtësitë e strukturës fonetike, gramatikore dhe leksikore të dy gjuhëve, të vërejtura prej shumë kohe në gjuhësinë ballkanike, kanë, në nivelin dialektor shqiptar, në shumicën e rasteve, shtrirje të kufizuar në dialektin toskë. Do t’ ishte për të nxjerrë një përfundim që ka të bëjë me historinë, ai që rumunët

² Është fjala për dukurinë e ndërrimit të gjinisë në shumës ose ambigjenisë (shën. i red.)

kanë pasur lidhjet fillestare me shqiptarët nga zona toskë. Pas gjithë gjasave, shqiptarët toskë mund të kishin zbritur, ashtu si rumunët frashërrjotë, nga trevat më veriore, ku mund të kishin pasur kontakt me rumunët. Në rumanisht, ngjashmëritë me shqipen kanë, në shumicën e rasteve, karakter të përgjithshëm, fakt që lejon hipotezën se kontakti midis shqipes dhe rumanishtes mund të kishte ndodhur në periudhën e rumanishtes së përbashkët, para ndarjes dialektore të saj. Të dy gjuhët, në kontakt të pandërmjetëm, trashëgjuan nga substrati trako-ilir disa tendenca që u konkretizuan në kohën e bashkësisë së tyre. Ja çfarë informata japin, në lidhje me këtë, hartat e veprës së dalluar të dialektologjisë shqiptare.

1.a. Në lëmin e fonetikës, ngjashmëritë midis shqipes dhe rumanishtes janë të shumta. Zanorja *ë* (rum. *ă*), pavarësisht nga pozita që ka në fjalë, është një tingull (fonemë) i përgjithshëm në dialektin toskë. Për shembull, *-ë* fundore ruhet në toskërisht, kurse në gegërisht, zhdukja e *-ë-së* pati si pasojë zgjatimin e zanores së rrokjes së mëparshme: (h. 1.a), t. *plakë*, g. *plāk*. Gjithashtu, *ë* e patheksuar në rrokjen nistore të hapur ruhet në dialektin jugor, por zhduket në atë verior: t. *gëzim*, *këpucë*, *përrua*, g. *gzim*, *kpuc*, *prru* (h. 47.b). Në pozicionin hundor, *ë* mbeti e pandryshuar në toskërisht dhe u bë *ā* në gegërisht. Trojet e të dy varianteve janë veçuar qartë (h. 38a, *zë - ri*, *lëmë*, *bëj* dhe h. 38b/1, fonemi /*ë*/ i theksuar në *zë*, *lë*: reflekset *ë* (dhe *e*) në jug dhe *ā* në veri).

Kështu, në shumë harta në vëllimin e parë pasqyrohet ruajtja e zanores qendrore *ë* (= *ă*) në të gjithë fqinjësitë e mundshme. Kjo situatë i përgjigjet jo vetëm asaj të dakorumanishtes, por edhe asaj të arumanishtes, dialekt i cili zhvillohet pranë dialektit toskë.

1.b. Rotacizmi i *n-së* së thjeshtë midis dy zanoreve në fjalët të vjetra, para ndikimit sllav, është një fenomen i përgjithshëm në toskërisht, si dhe në të folmen e lokaliteteve të Siqelisë dhe të jugut të Italisë, ku u shpërngulën qysh herët shqiptarët toskë. Në h. 64, zona gegë, me *-n-*, është kufizuar qartë nga ajo toskë, me *-r-*, me anë të shembujve: *dimër -i*, *bri -ri*, *pleqëri*, *veshur* (në gegërishten: *dimni*, *brini*, *pleqni*, *veshun*). Fenomeni i rotacizmit të *n-së* ndodhi dhe u zhvillua në shqip në të njëjtat rrethana me atë të trevës veriore të rumanishtes. Me rëndësi është fakti se në h. 64, midis zonave me *-n-* dhe *-r-* (poshtë Tiranës, duke ndjekur vijën Kavajë, Peqin, Librazhd, Pogradec) u regjistruan trajta të përziera: *-rn-*, *-nr-*, të njëjtit tip me ato të njohura nga gjuha e teksteve të vjetra rumune në veriun e Ardeal-it dhe të Maramureş-it.

1.c. Bashkëtingëllorja laringale *h*, e dendur në dialektin gegë, duket në të gjitha pozicionet (I, h. 8). Në toskërisht ka një luhatje si në rumanishte: ekziston qoftë në fillimin e fjalës, qoftë brenda saj, në pozicion ndërzanor, ose zhduket krejt. Kjo lëkundje e shqiptimit të *h-së* takohet edhe në të tjera gjuhë ballkanike. Në një sipërfaqe të gjerë në qendrën e Shqipërisë (si dhe drejt jugut dhe në të folmet shqipe në Itali dhe Greqi), *h* është zëvendësuar me *f* në folje si *leh*, *shoh*, *njoh*, *ftoh* (I, h. 57a, b). Në toskërisht, *h* midis zanoreve zhduket

vazhdimisht: *lahem* bëhet *laem* (I, h. 57c). Togu *hm* thjeshtohet, gati në mbarë truallin shqiptar, në *m*: *ndihmë* shqiptohet *ndimë*, *ndim*. Në qendër dhe në verilindje, *h* në bashkëlidhje me *m* mund kalojë në *f*: *nifem*, *nifm* (I, h. 57c).

Siç shihet, *h*, një frikative me shqiptim të dobët, ka një zhvillim të njëjtë në shqip dhe në rumanisht.

1.d. Në një hapësirë të kufizuar, më ruajtëse, në jugun e Shqipërisë, si dhe në Greqi dhe Itali, qiellzorja *q* del në stadin e saj të hershëm (të lashtë) *kl* (të shqiptuar me *l'*) në fjalë si: *qaj*, *qumësht*, *quhem* (I, h. 59a); shih h. 59a/2: *kl* në *qenë*).

Në të njëjtën krahinë jugore, edhe togu paralel *gl* (i shqiptuar *gl'*) u zhvillua në po atë mënyrë (I, h. 59b, togu i lashtë *gl* në *gju*, *zgju*, *i gjatë*).

Këtë shënim të posaçëm lidhur me paraqitjen në harta të togjeve bashkëtingëllore *kl*, *gl* e kemi bërë për arsye se këto janë ruajtur sidomos në fshatrat e banuara edhe nga arumunët frashërrjotë, të cilët togjet *cl*, *gl* i shqiptojnë, siç dihet, *cl'*, *gl'*: *cl'aie*, *gl'emu*.

1.e. Dallohen qartë në truallin toskë hapësirat e palataleve *nj*, *lj* (= *ń*, *l'*), të cilat në veri kaluan në *j*, I, h. 61b, *thonj*, *të rinj*, h. 62a, *laj*, *punoj* (në një truall toskë të gjerë: *lanj*, *punonj*; I, h. 62b, *vaj*, *gojë*, *bijë*, *fëmijë*, *shkëndijë* (në toskërishten jugore, variante me *l'*, i njëjti fonetizëm si tek frashërrjotët).

1.f. Siç dihet, në shqip ka një kundërvënie *r*: *rr* (*r* e thjeshtë dhe *r̄* e fortë, me dridhje apikale suplementare): *ruaj* dhe *rruaj*. Kjo kundërvënie neutralizohet në disa të folme toske dhe në gegërishten verilindore (I, h. 9, *rruaj*: *ruaj*), domethënë është përgjithësuar *r* e thjeshtë. E vëmë në dukje këtë për të treguar se edhe në arumanishten e Shqipërisë u zhvillua një *rr* (nga togu *rn*); gjithashtu, ka pasur *r̄* të fortë dhe në dakorumanishten e teksteve të vjetra.

1.g. Nga pikëpamja e ngjashmërive të mëdha që rumanishtja i ka me shqipen vëmë në dukje nga hartat e Atlasit një seri hollësirash fonetike lidhur me disa fjalë të fondit autokton të përbashkët.

Për shembull, në të folmen e shqiptarëve në Zarë, në bregun e Dalmatisë, ruhet togu i mocëm *rd* (i cili u zhvillua në *rdh*) në fjalë si *erda* (= *erdha*), *gard* (= *gardh*) etc. (I, h. 11b). Prandaj, rum. *gard* paraqit stadin e lashtë të fjalës së përbashkët rumuno-shqiptare.

Në hapësirën më veriore gege dhe në zonën e Podgoricës, shtegorja (fërkimorja) dhëmbore e zëshme *dh* shqiptohet, rastësisht, edhe si *ll*, një sonante anësore ekuivalenti i të cilës në rumanisht është *r* (për shembull: *mură*, alb. *mullë*); nga këtu, hipoteza se *mare* mb. do të shpjegohet me anë të formës dialektore shqipe *malle* (< *madhe*).

Në mbarë hapësirën veriore të shqipes qiellzorja *q* (= *k'*) u bë afrikate (I, h. 13a, b; *q*, *gj* në *qafë* dhe *gjak*), prandaj rum. *ceafă* do të krahasohet me një formë identike të shqipes.

Togu i tingujve *va*, në *vatër*, është i dialektit toskë, me të cilin krahasohet rum. *vatră*; në gegërisht i përgjigjet *vo*: *votër* (I, h. 56).

2. Në gramatikë, përkimet midis shqipes dhe rumanishtes pasqyruar në hartat e Atlasit janë, gjithashtu, të shumta dhe kanë një rëndësi të madhe.

2.a. Emrat përmbledhës, domethënë ato që tregojnë lëndë të pandërprera, të pandashme, kanë përcaktorë asnjans, ashtu si disa ekuivalente në rumanisht. Pikat më të shpeshta kartografike ku emra të këtilla kanë gjini asnjansë ndodhen sidomos në trevën toskë (duke përfshirë dhe jugun e Italisë dhe Siqelinë), shih I, h. 68/1 – 68/6, gjinia e emrave *újë, mish, djathë, lesh, dyllë, mjaltë*. Në rumanisht: *cârnuri, brânzeturi, lânuri*, forma shumësi përmbledhës, me mbaresën *-uri*, karakteristike për asnjansit.

2.b. Siç dihet, shqipja dallohet për shenjuesit me tepri dhe të ndryshëm që tregojnë kundërvënien e numrit të emrat. Ky fakt është shfaqur në shumë harta të vëllimit I (h. 71a dhe hartat në vijim). Për shembull, *gysh* ka shumësin në *-ë, -a, -ër, -re*; *grusht*: *-e, -a, -ë (ø), -ër*; *nip*: *-a, -ër (-ën), -ëra (-ra, -na), -e, nîp*; *gisht*: *-a, -ërinj, -inj, -ri, -ër, -ra, -re, -e*. Gjithashtu, forma të shumta shumësi kanë: *prift*: *-ërinj, -in, -a, -ër (-ën), -ra, -re, -e*; *përrua* (khs. rum. *pârâu, -aie, -ăie, -uri*): *përenj (prenj), prej, përon, -oj (proj) (-oja), pronje (-oje), projna, pronjëre, prora*; *gardh* (khs. rum. *gard, -uri*): *gardhe, -a, -na, -ni, -ej, -ice, -ie, -inj, -inie; gierdhe, gardhnje*.

Kundërvënia e numrit shprehet, në disa raste, edhe me anë të ndryshimeve në strukturën e rrënjës: *dash – desh, djalë – djem, yll – yje, kulaç – kuleç, thelb – thalb, lepur – lepuj, kërmill – kërmij, kalë – kuaj, vëlla – vëllezër*. Në raste të tjera kundërvënia neutralizohet: nj. *nxënës – sh. nxënës*; ajo rishfaqet gjatë lakimit.

Nuk morëm parasysh këtu variantet e formave të nyjshme, për shembull *mulli, mulliri*, me kallëzoren *mullirin* dhe *mullinë*; *sy, syri*, me kallëzoren *syrin* dhe *synë* etj.

Prandaj, shqyrtimi i hartave të Atlasit e provon faktin, të cilin gramatikat e shqipes e kanë treguar gjithmonë, se kjo gjuhë ka një fleksion emëror shumë të pasur. Nuk e teprojmë duke thënë se edhe rumanishtja, gjuhë romane, dallohet për numrin e madh të morfemave me anë të cilave shprehet kundërvënia e numrit tek emrat.

2.c. Ka në shqip disa emra jofrymorë që kanë përcaktorë mashkullorë në njëjës dhe femërorë në shumës. Këto janë të gjinisë e ashtuquajtur asnjansë, duke pasur të njëjtat karakteristika me emrat asnjans në rumanisht. Në hartën 137 (vëllimi I), kjo gjini ilustron me shembullin *mal* në togfjalëshin *mali i nalt* (mashk.) me shumësin *male të larta* (mbiemër femëror) si, për shembull, rum. *cătun frumos* “katund i bukur” (mashk.) me shumësin *cătune frumoase* “katunde të bukura” (fem.). “Asnjansë” është specifik për dialektin gegë; por ka hapësira me “asnjansë” edhe në toskërisht.

2.d. Hartat 89a, b e pasqyrojnë procesin e ngjitjes së nyjes së përparme të mbiemrit në strukturën e emrit të mëparshëm; *lopa e kuqe* del, në pika të shpërndara në tërë vendin, me nyjën mbiemërore të “gëlltitur” nga mbaresa e

emrit: *lopa kuqe* ose *lope kuqe*. Njëlloj, *viçi i zi* bëhet *viçi zi*. Këto realizime në gjuhën e folur vënë në dukje, edhe pse emri në togfjalëshin e dhënë ka njëj (lopa, viçi), procesin e shfaqjes së prapavendosjes së nyjes në shqipen dhe në rumanishten: *vacă a neagră* u bë *vaca neagră* “lopa e zezë”, *vițelu al negru* > *vițelul negru* “viçi i zi”. Kjo hipotezë në lidhje me origjinën e nyjzimit të prapavendosur është e njohur prej shumë kohe në gjuhësinë rumune.

2.e. E kryera e plotë e foljeve që tregojnë lëvizje bëhet me foljen ndihmëse *kam*, si në rumanisht: *kam shkuar*: *am mers*; *kam dalë*: *am ieszit* (I, h. 125a). Nga rregulli i njëtrajshmërisë së foljes ndihmëse në të gjitha kategoritë e foljeve largohet e folmja e Kosovës, ku foljet jokalimtare kanë *jam* në të kryerën: *jam shkue* (si në *gjuhët romane perëndimore*), me sa duket modeluar sipas serbishtes.

2.f. E ardhmja e dëftores formohet si në rumanisht.

α. *do* + lidhore: *do të shkoj*; *do* është e pandryshueshme dhe, pas gjithë gjasave, pavetore, si *o* (lat. *volet*), elementi përgjegjës në rumanisht, i cili ka hyrë relativisht vonë në tekstet të shkruara. Togu *do* + lidhore është i përgjithshëm në të dy dialektet kryesore të shqipes (I, h. 126);

β. *kam* + lidhore: *kam të shkoj*, ruajtur sot vetëm në jugun e Italisë dhe në Siqeli (I, h. 126); folja ndihmëse *kam* është e ndryshueshme sipas vetës dhe numrit, ashtu si folja përgjegjëse në rumanisht. Togu i llojit *am să merg*, i përgjithshëm dhe popullor, e pasqyron procesin ballkanik të zëvendësimit të paskajores (*am a cănta*) me lidhore. Pas gjithë gjasave, edhe në shqip formimi i strukturës me lidhore, i kufizuar tani në një të folme periferike, shpjegohet në të njëjtën mënyrë;

γ. *kam* + *për të* + pjesore: *kam për të shkuar* = *am de mers* dhe *kam* + *me* + pjesore: *kam me shkue* = *am de mers* (dhe *am a merge*). Në të dy ndërtimet, të shpeshta në gegërisht, me vlerën e kohës së ardhme (një e ardhme e domosdoshmërisë), vetëm folja ndihmëse ndryshon sipas vetës dhe numrit (I, h. 126).

2.g. Paskajorja shqipe shprehet në mënyrë analitike, me anë të një ndërtimi me pjesore: *për të* + pjes. (*për të punuar*), i shpeshtë në toskërisht dhe *me* + pjes. (*me punue*), i përgjithshëm në gegërisht. Në jugun e Shqipërisë, në Greqi dhe në Itali, “paskajorja” mungon dhe në vend të saj përdoret lidhorja (I, h. 130). Në të vërtetë, paskajorja shqipe e shprehur me anë të pjesores paraprirë nga parafjala është barasvlershme me *supin*-in rumun, një ndërtim me të njëjtën strukturë dhe me vlerë paskajoreje. Krahasimi me shqipen është një dëshmi se *supin*-i rumun ka dalë si pasojë e zhdukjes së paskajores së mirëfilltë.

2.h. Në shqipen jugore, pjesëza përemërore *u* në vetën e II-të shumë të urdhërores është vënë midis temës dhe mbaresës, për shembull: *uluni* (*ul - u - ni*), *lahuni* (*lah - u - ni*) (I, h. 135a, b). Format foljore me *u* të ndërfutur, shenjë e kuptimit pësor-vetvetor (nj.: *lahu*), mund të krahasohen me ato të rumanishtes së tipit: *duce-vă-ți* (prej *duceți-vă-ți*, me disimilim).

2.i. Foljet inkoative ndërtohen në toskërisht me fjali që përmbajnë lidhoren dhe në gegërisht me paskajoren: tosk. *filloi të pijë*; geg. *filloi me pī* (I, h. 142). Ndërtimi para-fjalor (analitik) me lidhore është ballkanik, i njohur edhe në rumanisht.

2.j. Folja gjysmëndihmëse [me vlerë modale] *duhet* – që i përgjigjet rum. *trebuie* – e ndërtuar me pjesore është shënuar vetëm në një pikë, në Labëri, në jugun e Shqipërisë: *duhet punuar*, rum. *trebuie lucrat*. Megjithatë ndërtimi *duhet* + pjes. përdoret zakonisht në gjuhën e folur. Por sipas të dhënave të Atlasit (I, h. 144) më i shpeshtë është ndërtimi me lidhore: *duhet të punosh*, me një kryefjalë të përgjithshme, të shprehur, mu si në rumanisht (*trebuie să muncești*), me anë të vetës së II-të njëjës.

Duhet shënuar edhe ndërtimi ekuivalent në gegërisht, me paskajore: *duhet me punu* (si në *gjuhët romane perëndimore*, për shembull: fr. *il faut travailler*).

2.k. Fjalitë qëllimore ndërtohen në toskërisht me lidhoren, si në rumanisht: *vete të pres dru*, rum. *mă duc să tai lemne*. Me të njëjtën vlerë sintaksore del edhe ndërtimi me paskajore *për të* + pjesore: *vete për të prerë dru*, i cili përkon në rumanisht me ndërtimin me *supin*: *mă duc la tăiat lemne*.

Në gegërisht, qëllimi shprehet me anë të paskajores: *vete me pre dru* ose *vete për me pre dru* (I, h. 145), që është për të barazuar në rumanisht gjithashtu me *supin*.

I kemi kushtuar një vëmendje të veçantë materialit dialektor që gjendet në hartat e vëllimit të parë të Atlasit për të treguar se mund të ekzistojnë dëshmi suplementare të faktit se ngjashmëritë midis rumanishtes dhe shqipes dalin jo vetëm në leksik, si mendohet zakonisht, por edhe në fonetikë dhe gramatikë, ku ka gjithashtu fenomene të shumta. Këto ngjashmëri qenësore nuk duken të rastit dhe as të zhvilluara vonë. Ato mbajnë farefisninë (lidhjen) gjenetike të dy gjuhëve nga ana e substratit të përbashkët.

Fenomenet që paraqitëm këtu i kemi hulumtuar hollësisht gjatë kohës: zanoren *ă*, bashkëtingëlloren *h*, rotacizmin, gjininë asnjënëse, urdhëroren, *supini*-in, prapavendosjen e nyjës etj. Kërkimet i kemi botuar në *Studii de istorie a limbii române*, I, II, Editura Academiei Române, 2007, 2009 (“Studime të historisë së gjuhës rumune”, I, II); punime të shumta gjenden në vëllimin *Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române*, Institutul Român de Thracologie, Bibliotheca thracologica, VIII, 1995 (*Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune*, titulli me të cilin libri ka dalë më 2009, në gjuhën shqipe në Tiranë, në përkthimin e Luan Topçit).

3. Vëllimi i dytë i Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe përmban lëndë leksikore të organizuar, si kemi treguar tashmë, në fusha kuptimore, më saktë, në terminologji popullore. Shumë harta përfshijnë një fond sinonimesh shumë të pasur. Këto janë për studiuesit të gjuhës shqipe burime materiali (të lashtë,

dialektologjik, popullor) për kërkime onomastike me interes të madh për gjuhësinë ballkanike në përgjithësi.

Këtu u ndalëm, si më lart, te fjalët e stërlashta që shqipja dhe rumanishtja i kanë së bashku. Vërejtjet që bëjmë (përhapje dialektore, variante arkaike etj.) mund të konsiderohen si një plotësim i kërkimeve monografike që i kemi botuar në *Vocabularul autohton al limbii romîne*, Editura Științifică și Enciclopedică, 1983 (“Fjalori autokton i gjuhës rumune”). I kemi radhitur fjalët sipas rendit të hartave në Atlas.

gjëmb (h. 166), fjalë me të cilën krahasohet rum. *ghimpe*, del vetëm në dialektin toskë dhe në dialektin gegë qendror. Në dialektin toskë është regjistruar edhe varianti i vjetruar *glemb*, *glem*, me *gl*.

mace (h. 178) është një fjalë me përhapje të përgjithshme, kështu që krahasimi me rum. *mâtă* s’duhet përjashtuar, sidomos sepse në trevën e Shkodrës është regjistruar edhe variantin *mitsë* dhe madje *mâtse* (me *a* hundorëzuar). Ekuivalenti mashkullor (h. 176, *maçok*) del me variante që dallohen në segmentin fundor: *maçok*, *maçek*, *maçor*, *maçur*.

gomar (h. 182) është i njohur në dialektin gegë, si dhe në shqipen e Kosovës dhe të Maqedonisë, me var. *magar*, si në gjuhën rumune; në të njëjtat krahina, dhe derivati femëror *magaricë* (: rum. *măgăriță*) (h. 183).

mëz, *-i* (dhe var. *mës*, *mãz*, (h. 187) gjendet në mbarë hartën e Shqipërisë, me pak sinonime në dialektin toskë dhe në të folmet të Italisë jugore. Në jug, në Himarë (pika 121), ku ka shumë arumunë, del var. *mëndz*, *-i* (me *dz*) dhe, gjithashtu në jug (pikat 119, 139), fem. *mëzë*, *-a*, si rum. *mânză* (shih edhe h. 205, *mëzat*).

mushk(ë), *-a* (h. 188) është e njohur në të gjitha të folmet shqiptare, gjithashtu në ato të folura jashtë Shqipërisë. *Mushkë* bashkëjeton me m. *mushk*, *moshk*; pra, një rrënjë identike me atë që gjendet në rum. *mușcoi*, fem. *mușcoaie* (arom. *mușcu*).

berre, *-t* (dhe *berra*, *-t*) sh. “bagëti e imët”, sinonim i fjalës *dhen*, *-t* (h. 189), del rastësisht pranë Durrësit, në Mirditë dhe sidomos në zonën e Podgoricës në Malin e Zi. Me sh. *berre* krahasohet rum. *bâr* (sidomos në togun : *bâr*, *oaie*), pasthirmë për të sjellë delet.

dash, *-i* (h. 190) del në mbarë truallin ku flitet shqip, është një fjalë të trashëguar; me këtë ka lidhje rum. *daș* “qengj”, e ndeshur rastësisht në krahinë Muscel, në veriun e Vllahisë (krahinë në jugun e Rumanisë) (*daș* është, megjithatë, e përgjithshme në dialektin arumun dhe në atë meglenorumun, me kuptimin “qengj”).

shtjerrë, *-a* (dhe var. *shqerrë*, *shqjerrë* dhe m. *shterr*, *-i*, *shter*) “qengj” është e njohur vetëm në toskërisht rreth Pogradecit dhe Korçës, ku ka edhe shumë arumunë (h. 191, *qengj*, *-i*, dhe h. 193, *milor*, *-i* “qengj një deri dy vjeç”, termi i përgjithshëm). Është për të vërejtur se kuptimi “shterp” (për kafshë dhe femra) nuk gjendet në hartë; ky është i njohur nga të tjera burime leksikore

(*shtirë* em. “bagëti shterpë”, rum. *știră*; shih, megjithatë, h. 351 *djerr*, -i “tokë e papunuar”, me sinonimet *shtaire* (= *shtirë*) në Myzeqe dhe *shtjer*, -a, *shterp*, -a në Maqedoni.

çjap, -i (h. 196) është një fjalë e përhapur në mbarë truallin e gjuhës shqipe. Megjithatë, afër Korçës, e veçuar, edhe *përç* (: rum. *pârçi*), fjalë sllave.

kec, -i “i vogli i dhisë pa mbushur vitin” (h. 197), fjalë e përgjithshme në toskërisht, që do ta krahasojmë me rum. *chet*, pasthirmë për të sjellë edhat dhe dhitë. Në veriun e Shqipërisë (dhe në Kosovë, në Malin e Zi, në Maqedoni) përdoret vetëm *edh* (dhe *kedh*, i përzier me *kec*) nga lat. *haedus*, që mund të jetë ruajtur si pasojë e kontaktit me barinj të rumunë.

ftujë, -a “kec femër nga një vit deri në dy vjeç” (h. 198), dhe *ftunj*, *ftujk*, *ftujëz*, *ftule*, *vetule* (shih dhe h. 199, *ftujak*, -u). Përmendëm këtë fjalë sepse ka gjuhëtarë të cilët konsiderojnë rum. *vătui* “edh ose këlysh lepur” si element substrati.

shytë, -a (h. 200) është një term i përgjithshëm. Variantet e njohura nga burime të tjera, *çutë* dhe *sutë*, nuk dalin.

mështjerrë, -a “viçe e madhe deri sa të pjellë” (h. 234), term me përhapje të përgjithshme, përveç trevës së Elbasanit dhe Korçës, ku regjistrohet me këtë kuptim *mëzore*, fjalë e prejardhur nga *mëz*, njëlloj si rum. *mânzare* “dele që jep qumësht” nga *mânz*; *mështjerrë* ka të ngjarë të jetë rezultati i përzierjes së fjalëve *shtjerrë* dhe *mëz*, *mëzore* (shih dhe h. 191).

mëzat, -i “viç nga një deri tre vjeç; dem i ri” (h. 205) është e njohur në dialektin gegë dhe në pika të vetmuara në toskërishten jugore. Bën pjesë në familjen e termave të prejardhura të emrit *mëz*, me të njëjtën strukturë leksikore si atë të rum. *mânzat* (shih dhe h. 187 *mëz*).

sorrë, -a (h. 210), fjalë e përgjithshme ashtu si rum. *cioară*; në toskërishten lindore: *galë* “stërqokë” (khs. rum. *gaie*).

gjon, -i (h. 218) “shpend grabitqar më i vogël si kukuvajka, që këndon natën në verë”. Është një fjalë e njohur vetëm në toskërisht dhe tek arbëreshët e Italisë. Në Myzeqe del me kuptimin “shpendi i natës”, kurse në Dalmati me kuptimin “shpend i keq”. Rum. *ghionoaië* është një formim i brendshëm.

rosë, -a (h. 226), fjalë me të cilën do të krahasojmë rum. *rață*, del në mbarë truallin. Në gegërisht, më rrallë, përdoret *rikë* (në rumanishte, *rică* është pasthirmë për të thirrur rosat).

këpushë, -a (h. 232), fjalë me të cilën mund të ketë lidhje rum. *căpușă*, është e njohur vetëm në toskërisht.

kopile, -ja “vajzë” del vetëm në një pikë, tek arbëreshët e Italisë (h. 245). Kuptimi është identik me atë të rum. *copil*.

gjysh, -i “i ati i babait ose i nënës” dhe *gjyshe*, -ja “nëna e babait ose e nënës” (h. 253) janë fjalë të shpeshta në të gjithë të folmet shqipe. Në rumanisht, *ghiuj* ka një përdorim të kufizuar në kuptimin “plak” dhe del vetëm në mashkullore (sot është mjaft e rrallë).

kurm, si sinonim i fjalës *trup*, gjendet vetëm në shqipen e Greqisë dhe të Italisë (h. 267 “trup”). Termi me prejardhje sllave është gati i përgjithshëm, me vërejtjen se në të folmet veriore bashkëjeton me sinonimin latin *shtat*. Prej emrit *kurm* u formua folja *kurmoj* “ndaj një dru përmes”, me të cilën mund të lidhet rum. *a curma*. Përhapja alb. *kurm* në zonën jugore flet më shumë për një shpjegim nga greqishtja.

fyell përdoret si metaforë në *fyelli i këmbës* si në rumanisht: *fluierul piciorului* (shih h. 279, në pika të zonës së Korçës, por edhe në Veri, në Mirditë). Në të folmet e Greqisë del një formë më e afër me atë të rumanishtes: *flojer e këmbës*.

shkrep fol. del në disa pika jugore me kuptimin “trazoj (zjarrin)”: *shkrep zjarrin* (h. 292).

gudulis fol. (rum. *a gâdila*) është një fjalë e përgjithshme në toskërisht (h. 293). Ka gjuhëtarë që vënë të dy fjalët në lidhje etimologjike.

shkrum (dhe *shkrump*, *shkrumz*, *-a*) me kuptimet “blozë; urë zjari” (h. 312 “blozë”) është një term i rrallë: një pikë pranë Tiranës, një tjetër në Labëri (në jug) dhe dy pika në Kosovë. Me të njëjtin kuptim përdoret dhe *shpuzë* në një pikë në jugun e Kosovës.

krunde, *-t* pl. “mbeturinat e miellit të situ, hime” (h. 315) njihet gati në tërë zonat e shqipes (bashkë me krahinat ku ka shqiptarë në vendet fqinje nga veriu). Krahasohet me rum. *grunz*, ar. *grundā*, megl. *grunj*; shih dhe h. 364 “plis, *-i*”, ku shihet *grund*, *-a* në Kosovë dhe në Maqedoni me kuptimin “plis, buçë”.

ajkë, *-a* (shih var. *alkë*, h. 328) është një fjalë e përgjithshme në dialektin toskë. Mund të krahasohet me *aicā* në dakorumanishten e vjetër (sot *arichiță* “çfarë mbetet nga hirra e qumështit pasi nxirret gjiza”, “Fjalori i Akademisë” = DA, s.v.). Është për të vërejtur se *ajkë* del në gegërisht (bashkë me të folmet shqipe në Kosovë, Makedoni dhe Mali i Zi) me kuptimin “lyra e leshit; djersë e yndyrshme në lëkurën e bagëtive dhe në flokët e njeriut”, shih h. 392, *lyrë*, *-a* (e *leshit*), kuptim i njohur edhe në shqipen e Greqisë.

mullëz, *-a* “tharm për djathë; tharm që nxirret duke e regjur në ujë mullën e tharë të qengjit, të kecit a të viçit” njihet përgjithësisht në toskërisht, por edhe në Kosovë (h. 331). Është një fjalë e krahasueshme me rum. *murzā*. Në zona të shpërndara në të dy dialektet del dhe *rrëndë* (*rrān*, khs. rum. *rānzā*).

këpucë, *-a* “mbathë e njeriut” gjendet në të dy dialektet (h. 335). Disa gjuhëtarë (Miklosich, Philippide, Jokl etj.) vënë në lidhje etimologjike këtë fjalë me rum. *căpută*, ar. *căpută*.

sumbull, *-a* (var. *sumull*, *sumell*, *sumbë*, *thumbi*, *thumbëz*, *thumbuz*) “kopsë e vogël” (h. 339, *kopsë*), fjalë me të cilën mund të krahasohet rum. *sâmbure*.

stan, *-i* (h. 340) del në tërë Shqipërinë (sinonim me *kasolle* në Malin e Zi dhe me *këlive* në veriun e Greqisë, në zonat arumune). Origjina autoktone e rum.

stână, alb. *stan* është mbrojtur nga shumë gjuhëtarë.

tsark, -u “vathë” dhe var. *thark* (h. 341). Fjala mund të krahasohet me rum. *țarc* dhe është e përhapur sidomos në Myzeqe.

shtrungë, -a “shteg i ngushtë afër derës së vathës, vathë” është një fjalë e përgjithshme (h. 342), ashtu si rum. *strungă* që i përgjigjet.

shterp, -a “tokë djerr” (h. 351) del me këtë kuptim (më të shpeshta janë *djerr*, *lëndinë*) vetëm në disa pika të Maqedonisë (khs. rum. *sterp*, për tokën e papunuar).

grep, -i “shat, shatë” (h. 352, “çapë”), me kuptimin e përgjithshëm “mjet për të zënë peshk; gremç, çengel” (ndaj Pogradecit, në jug, ka kuptimin “furkë”, h. 376), mund të jetë në lidhje etimologjike me rum. *grapă*.

grihë, -a “gur i ashpër për të mprehur kosa” (h. 381) është një term i përgjithshëm, lidhur etimologjikisht me foljet *grih* “mpreh me grihë”, *grij* “pres në copa shumë të vogla; gërryen, bren”. Në të njëjtën familje bën pjesë folja *gërryey* “kruaj, brej”, nga e cila është formuar emri *gërresë* “vegël që shërben për të gërryer a për të kruar” (fjalë që nuk gjendet në Atlas) me të cilin krahasohet rum. *greasă*, *gresie* (me ndryshim lakimi).

argali, -ja (var. *argëli*), në shqipen e jugut, në atë të Greqisë dhe të Italisë jugore, me kuptimin “vegjë, avlëmend”, khs. rum. *argea* “vegjë, avlëmend, tezgjah”. Termi shqiptar (shih h. 382 “avlëmend”) mund të identifikohet gjithashtu me gr. *αργαλειός*, id.

kërig, -a (*krriga*, -t, *krrigëz*, -a) “shtizë për të thurur, citë”, në Mallakastër (jugu i Shqipërisë), h. 386 “shtizë, -a”. U ndalëm te kjo fjalë krahinore sepse ka gjuhëtarë që e konsiderojnë rum. *cârlig* si term substrati.

kurth, -i (*kurth*, -a) “mjet për të zënë kafshë të egra, çark, grackë”, rum. *cursă*; del në gegërishten veriore dhe, gati në të njëjtat zona, *hekura*, -t, sh., term i krahasueshëm nga pikëpamja e kuptimit me rum. *fiare* sh. “grackë” (h. *çark*, -u).

vatër (I, h. 56), rum. *vatră*, është njohur në toskërisht; në gegërisht: *votër*.

Siç shihet, në Atlas dalin 40 fjalë që shqipja dhe rumanishtja i kanë të përbashkëta. Një hulumtim monografik të këtyre fjalëve e kemi bërë në vëllimin e përmendur më lart; këtu u kufizua t’i përkrahujmë përmblodhtas. Kemi lënë mënjanë fjalët që gjenden në hartat për shkak të veçorive fonetike të tyre ose sepse hyjnë në togje me vlerë metaforike: *qafë*, *përrua*, *gardh*, *shterp*, *tsapë*, *bukël*, *bukuroshë*, *brez*. Nuk i patëm parasysh as fjalët e krahasueshme me rumanishten për sa i përket tipareve semantike ose strukturës leksikore, siç janë *vëllam* (: rum. *fârtat*), *tambël* “qumësht” (: rum. *dulce* “ushqim (bulmet) i ndaluar në kreshmë”), *lyrë* (: rum. *usuc în lână*), *shkues* (: rum. *mergător* “shkues”), *fejoj* (: rum. *încredințez*), *këlysh* (: rum. *căluș*), *nusez* (: rum. *miresică*, *nevăstuică*), *brezi perëndisë* [: rum. *brâul lui Dumnezeu* “ylber”], *shark* (rum. *sarică*) etj. Numri i tyre është shumë i madh. Si përfundim, duhet thënë se, nga këndvështrimi i rumanishtes, fondi leksikor popullor i vënë në

hartat të Atlasit shqiptar, bashkë me elementet fonetike dhe gramatikore, jep një pamje mjaft të qartë të lidhjes gjenetike midis këtyre dy gjuhëve.

* *
*

Më 2011 Titos Jochalas botoi në Athinë dy vëllime kërkimesh mbi të folmet shqipe të folura sot në Greqi³. Vëllimi i parë përmban tekste të ndryshme (përralla, rrëfenja, kujtime, copa folklorike ose të gjuhës së folur etj.), të shoqëruara me shënime, shpjegime, komente, kurse i dyti regjistron fjalorin e pasur nxjerrë nga këto tekste.

Në fjalorin e Titos Jochalas u ndalëm te ato fjalë shqipe që kanë fjalë përgjegjëse të njëjta ose shumë të afërta në rumanisht. Disa dalin edhe në pikat që gjenden në truallin grek në Atlasin dialektor të gjuhës shqipe. Për këtë arsye, lista që japim këtu duhet vështruar si një shtojcë, plotësim i materialit që e volëm në Atlas⁴. Kemi përdorur transkriptimin e autorit; fjalët përgjegjëse rumune i japim ndër kllapa; në disa raste, japim dhe fjalët greke përgjegjëse.

alkë, aljkë (aică, arichiță “çfarë mbetet nga hirra e qumështit pasi nxirret gjiza”). *baljtë-a (baltă* “pellg, liqen, hurdhë”), gr. *η λάσπη: Shtëpinë e bënjëm me baltë nga botë edhe me gurë.*

bardhë (i, e) (barz, bardz “i bardhemë, e bardheme; i, e hirtë”), fjalë të prejardhura: *zbardhënj, i zbardhur*. Për të vërejtur edhe var. *barxë*, me [dz], “i larmë, gjysmë i bardhë e gjysmë ngjyrë kafe” (për dhitë). Mundet se var. me x [= dz], që del në të folurit baritor, të jetë ndikuar nga dialekti arumun.

barsë (: borç “bark i madh ose i fryrë”, *borçoasă* “shtatzënë, grua me barrë”), folje e prejardhur: *barsem* “mbarset, bëhet me barrë”; khs. *barrë* : rum. *sarcină, greutate, povară: Ishtë me barrë*: rum. *e însărcinată, e cu sarcină*.

berr-i, sh. berra (bâr, pasthirmë për të sjellë, për të përçuar delet ose dhitë; folje e prejardhur bârâi “çoj, sjell, përçoj delet”, emër i prejardhur: *bârâiac* “qengj”) (gr. *το γιδοπρόβατο*).

bisht-i (khs. rum. *păstaie* “bishtajë”).

brez-i (: rum. *brâu* “brez”); *brezi i kallogresë* (: rum. *brâul călugăriței* “ylber”).

bredh-i (rum. *brad*), emër i prejardhur *bredhjonë-a* “bredhishtë, breshtë”.

brúshullë-a (rum. *brusture*).

³ T. Jochalas, *Η αρβανιτιά στο Μοριά (χρονικά πορείας)*, I–II, Athinë, 2011.

⁴ Për vërejtje të hollësishme mbi etimologjinë dhe përhapjen gjeografike të termave të përbashkët ndërmjet dy gjuhëve, shih, ndër të tjera, Gr. Brâncuș, *Vocabularul autohton al limbii române*, București, 1983.

bukur (*i, e*) (khs. rum. *bucur* “i bukur” (kuptim supozuar në emrin e njeriut *Bucur*), *bucuros* “i gëzuar”, *bucura* “gëzoi”).

buzë (*buză*), prejardhur *buzalla-i* “me buzë të trasha, buzaç”; shumë fjalë të përbëra (me kuptime të ndryshme): *buzë e kaut* (: *buza boulu*), *buzëkuqe* (: *buză-roșie*), *buzëbardhë* (: *buză-albă*), *buzëzi* (: *buză neagră*), *buzështrëmbërë* (: *buză strâmbă*).

cark-u [= *tsark*], variant më i lashtë se *thark*, ashtu si format rum. *țarc* dhe gr. *τσάρκος*.

cjap [= *tsjap*] : *țap*.

çoke [= *çoke*], *cok-u* “lingë, zile e vogël në qafën e një dhie” (khs. rum. *cioc*).

dash-i (: *daș* “id”).

flojërë-a (: *fluier*), khs. gr. *φλογέρα*.

fleturonj, fljutëronj (khs. rum. *fluture* “flutur”).

gardh-i “kopsht” (rum. *gard* “gardh”), gr. *ο χήλος*: Hyri dhia ne *gardh* edhe më hëngjëri domátatë (Hyri dhia në kopsht dhe mi hëngri domatet).

gátí (: *gata*).

glim-mbi; glëmba (: *ghimpe*); var. me *gl-* është më i vjetër se *gjëmb* (gjithashtu: *gluhë*

> *gjuhë, glisht* > *gjisht, glju* > *gju*); Pishqitë kanë *gljëma*.

gushë-a (: *gușă*) “mjekër, gushë; sëmundje e deleve”, gr. *αρώστια* *προβάτων*; *gushëkuq* “shpend me puplajë të kuqe në qafë”.

gropë-a (: *groapă*).

gjon-i (khs. rum. *ghionoaie* “qukapik”).

hudhrë-a, hurdhë-a (khs. rum. *urdă* “një lloj djathi”), gr. *το σκόρδο*.

kaçullë-a, ksulje-lja (: *căciulă*), emër i prejardhur *kaçuljer-i* “mashkulli i laureshës”; është për të vërejtur var. me *ç*, si në rumanisht.

kalbëtë (*i, e*), mbiemër i prejardhur nga folja *kalb* (khs. rum. *câlbează*) dhe

qelp-qelbi, qelbem “lëshoj një erë të rëndë”.

këpucë-a [këputsë], *kupucë* (: rum. *căpută*).

katunt-ndi (: *cătun*).

kopíl (: *copil* “fëmijë”) “shërbëtor”, *kopílje-lja* “vajzë” (në shqipen e përbashkët *vajzë*, gr. *η κόπη*).

kurm-i “trung” (: rum. *curma* “ndërpres”): *kurmi i lisit*, gr. *το κόρμι*.

krúnde-të “mbeturinat e miellit të situr, hime” (: *grunz* “top, kokër”).

maç-i, máce-a (: *măță*).

mal-i (: *mal* “breg”).

madh (*i*) (: *mare* “i madh”).

mëzore-a (: *mânzată*).

miljor (: ar. *mil'or, mil'oarā*).

mullëzë-a “tharm” (: *mură* “stomak, rrécok, tharm”, ar. *amurā*).

mushk-u dhe f. *mushkë-a* (: *muşcoi*, ar. *muşcu*).

nëpërtë-a “nepërkë, nepërtkë” (: *nāpārcā*).

qafë-a (: *ceafā* “zverk”), gr. *τρόχηλος*.

sembri-a “shoqërim” (*sāmbrā* “id”; ~ oilor “bashkimi i tufave të deleve për kullotë”).

sorrë-a (: *cioarā* “stërqokë, galë”).

strigëzë “magjistare”; gr. *η στίγλα*; rom. *strigă, strigoi, strigoaie* “lugat”; por del edhe *shtrig-a* “jetim”, gr. *ο ορφανός*.

shterpë (: *stearpā*), gr. *η στέρφα γίδα*.

shkrep(u) “rrezatim” (: *scāpāra* “shëndris, shkrep”): *i shkrepurë* “i shkëlqyer”.

shtrepa-të (: *strepede* “krimb djathi”): djathëtë ka *shtrepa* (ar. *ştrepu*, me formë të ribërë pas fjalës shqipe).

shqërra-të, shtjérrë “qengj, qengja” (*ştirā* “shterpë”).

shtrungë-a (: *strungā*): *shtrungë* thomë atje çë mjellmë; gr. *στρούγκα*; emër i prejardhur *shtrungulíth* “gur mbi të cilin rri çobani kur mjel”, gr. *ο στρογγόλιδος*; Copani ve një gur edhe ja thomi *shtrungulíthi* edhe rri siprë edhe mjel. Prandaj, *shtrungë* (*strungā*) është dera në gardhin e vathës ku milen delet. Duhet shtuar fol. *shtrungulisinj* “i sjell delet në shtrungë për t’i mjelë”.

shutë-a “1. gungë në qafë; 2. kërrutë” (: *ciutā* “sutë”), *krrutë* “dele me brirë” (: rum. *cornutā*); në shqipen nuk ka variant me ç.

trastë-a (: *traistā*).

vatrë-a (: *vatrā*), gr. *εστία*.

vjedh, vjedhënj (khs. rum. *viezure* “baldosë”).

xhapí-u [= *ğapí*] dhe *xapí-u* [= *dzapí*] (khs. rum. *şopārlā*) “hardhucë e madhe dhe e verdhë”; duhet shtuar *zhapë* [= *žapë*] “mish rrypak; lëvozhgë e fortë”.

49 nga këto terma bëjnë pjesë me siguri në fondin e përbashkët shqiptaro-rumun që vjen nga substrati. Shtuam edhe fjalët *bisht, këpucë, mace, sembri, strigëzë*, për të cilët disa gjuhëtarë mendojnë se mund t’i përkasin fondit pararomak; emri *milor* vjen nga e folmja e barinjve arumunë.

Siç shihet, numri i fjalëve të përbashkëta kanë rëndësi, ashtu si numri i fjalëve që kemi gjetur në hartat e Atlasit, fakt i cili provon se, në tërësinë e leksikut popullor, ato përfaqësojnë përfaqësisht një grup 60 termash, shumë të rëndësishme në përvojën e zakonshme të komunikimit elementar, themelor.

Në tekstet që Titos Jochalas i voli në vende të ndryshme të zonave Laconia, Argolida, Corint ka dhe shumë ndërtime, shprehje, thënie, kuptime të posaçme të përbashkëta me rumanishten dhe, shpesh, me greqishten dhe me gjuhë të tjera ballkanike. Paraqitim këtu, pa një radhë të caktuar, një pjesë nga kjo lëndë e vyer, plotësuar me ekuivalentet rumune:

dì arbërishtë: ştie româneşte (dhe me variantin e huazuar nga greqishtja: *arvanitiqe*).

java e madhe: săptămâna mare, java djathit: săptămâna brânzei (me gjinoren); *java mishi: săptămâna de carne* (rasa rrjedhore shqip, ndërtim me parafjalë rumanisht).

bithëpulje: cur de găină (emri popullor i një sëmundjeje të lëkurës).

sa *bën* peponi: *cât face* pepenele (= kushton).

cë bën?: ce faci? (formulë pritjeje).

të të marrë djallëthi: lua-te-ar dracul (në mallkime, nëma).

dalli djelli: a ieșit soarele.

menate: de noapte.

morratë më hëngre krietë: mă mănâncă păduchii în cap.

puçë [putsë]: puță.

bre: bre (gr. ρε, βρε).

burrë: bërbat “i shoqi”: Asanë gruasë i vdiq *burri* : acelei femi i-a murit *bërbatul*.

i marrë: luat, apucat “i çmendur”; gr. *τρελός*.

mbecë mirë: rămâi cu bine.

i bie mirë: îi cade bine.

misërdhe (= mirë se na erdhe): *bine ai venit.*

dorëzë (zvog.): *mănușă* “vjegë”.

tata: tată; mëmë: mamă.

keq e bukurë: frumoasă rău “shumë e bukur”; ishtë sëmurë *keq* = e bolnav *rău* (*keq, rău* me vlerë sipërore).

më muar malli (të vete në katunt): *mă apucă dorul* (să merg în sat).

kljumështi u prish: laptele s-a stricat “u mpiks, u ngjiz”; dhe: *kljumështi u pre: laptele s-a tăiat* (la fiert).

mirë-a, sh. mira-të: bunele (mit.)

na: na (gr. να), fjalë ballkanike.

allarghu: klisha ishtë allarghu, me *a-* të përparme ndoshta pas *arum. alargu* (khs. dhe gr. *αλάργα*).

nusezë : nevăstuică, gr. *νυφίτσα*.

Botuar rumanisht në

“Fonetica și dialectologie”, București,
XXXI, 2012, f. 5-19

Përktheu: Dr. Cătălina Vătășescu

SUMMARY

THE ALBANIAN DIALECTAL ATLAS AS A FURTHER PROOF FOR SIMILARITIES BETWEEN ALBANIAN AND ROMANIAN

Our research highlights from a diachronic perspective the linguistic similarities between Romanian and Albanian as they are reflected in various maps of the *Albanian Dialectal Atlas*. We are bound to observe that this Atlas is the result of an extremely well devised set of dialectal questions (“Questionnaire”), which have enabled the cartographic representation of such features as are necessary to outline a sufficiently neat image of the historical cognation between Albanian and Romanian. The two volumes of this atlas provided us with a linguistic material we have corroborated with what we find in the work of Titos Jochalas (*Η αρβανιτιάστο Μοριά (χρονικά πορείας)*, I–II, Athens, 2011) on the subject of Albanian idioms spoken in Greece.

